



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË

Nr. 325.. Prot.

Korçë, më 15.03.2022

**SHPALLJE KONKURSI PËR DREJTOR INSTITUCIONI ARSIMOR TEK SHKOLLA
“DILAVER NEZHA” , ZVAP PËRRENJAS**

Në mbështetje të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, , Urdhrit të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë me Nr 31 datë 28.01.2020 “Për Miratimin e Rregullores për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore”, Udhëzimit Nr 30 datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve në klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar, kreut I, gërma A dhe gërma B, të Udhëzimit Nr.2 datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar” i ndryshuar,

Shpallet konkursi tek Shkollat;

“Dilaver Nezha” ZVAP Përrenjas

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për pozicionin drejtues institucioni arsimor :

Të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar” dhe vlerësim jo më pak se “Mirë” në kualifikimin e fundit.

Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar ose të jetë pranuar për të kryer atë.

Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin drejtues institucioni arsimor;

· Jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumentave që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të shtojcës 1/Udhëzimi Nr.2 datë 28.01.2020, i ndryshuar)

· Kopje e njësuar me origjinalin e librezës së punës(e noterizuar)

· Kopje e dokumentit të identifikimit (ID).

· Tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr 4 të Udhëzimit).

· Certifikatën e drejtuesit të IAPP ose vërtetim nga Shkolla e Drejtorëve që është pranuar për ta kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor.

· Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore (sipas shtojcës nr 2 bashkëlidhur udhëzimit)



Adresa: “ Dhimitër Denasi”
Lgji. 18, AL 7001, Korçë
ëbsite: <http://korce.arsimiparauniversitar.gov.al/>

- Vërtetim nga institucioni ku punon se aplikanti nu ka ka masë disiplinore në fuqi.
- Deklaratën e mungesës së konfliktit të interesit të aplikantit me punonjësit arsimorë të institucionit arsimor, ku po konkurren për pozicioni drejtues (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prind të bashkëshortit/es) (sipas shtojcës nr 3 bashkëlidhur udhëzimit).

Aplikanti për drejtues institucioni arsimor duhet të paraqesë në ZVAP Përrenjas dosjen personale me dokumentacionin e sipërshënuar me anë të shërbimit postar, nga data 15.03.2022 deri 24.03.2022

Pas shpalljes së procedurave dhe publikimit në faqen zyrtare nga DRAP Korçë, të njoftohet zyrtarisht ZVAP Përrenjas, për shpalljen e këtyre procedurave edhe në faqen zyrtare të ZVAP Përrenjas dhe ambjenteve publike të saj.

DREJTORI
KRISTAQ GRABOCKA

